

Druri në identitetin arkitektonik - Një pasqyrë mbi zhvillimin e arkitekturës me bazë druri në Kosovë

*Arta Januzi-Cana**

Abstrakt:

Arkitektura tradicionale me bazë druri është trashëgimi e çmuar e Kosovës, që është zhvilluar në relacion me klimën, pozitën gjeografike, rrethanat politike, diversitetin e ndikimeve kulturore, qasjen në materiale ndërtimore dhe njohuritë në teknikat e ndërtimit. Në këtë kontekst, ky punim trajton tipologjitë e objekteve në dy aspekte: sistemet e ndërtimit tradicional dhe strukturat bashkëkohore, duke i analizuar dhe klasifikuar elementet strukturore si dhe duke i interpretuar vlerat arkitektonike. Është dhënë një përshkrim kronologjik që pason me shpjegim të detajuar. Janë paraqitur detaje dhe të dhëna teknike lidhur me mënyrat e ndërtimit duke u bazuar në literaturën përkatëse dhe studimin në terren të arkitekturës tradicionale dhe bashkëkohore me bazë druri. Për më tepër, është përshkruar artizanati dekorativ në dru i mjeshtrit popullor kosovar, që zë një pjesë të rëndësishme në shtëpinë tradicionale. Në përfundim, punimi pohon disa rezultate të kategorizuara duke pasuar me sugjerime përkatëse. Sugjerimet adresohen drejt rëndësisë së arkitekturës tradicionale dhe bashkëkohore me dru në Kosovë, rëndësisë së mbrojtjes dhe zhvillimit të mëtejshëm të aplikimit të drurit në ndërtimtari.

Fjalë kyç: *Ndërtimi me dru; Arkitektura tradicionale/Vernakulare; Identiteti vendor*

* *Arta Januzi-Cana, MSc., PhD Cand., IDAUP International Doctorate Architecture and Urban Planning, Universiteti Polis, Shqipëri dhe Universiteti i Ferraras, Itali e-mail: artajanuzi@hotmail.com*

Hyrje

Druri, si materiali më i vjetër ndërtimor, është nga materialet më të përdorura gjithandej edhe në Kosovë deri në fillimin e kohës së industrializimit. Kosova shtrihet në Evropën jug-lindore, në qendër të Gadishullit Ballkanik,¹ si rrjedhojë trashëgimia arkitekturore është e ngjashme me regjionin, në kuptimin e teknikave të ndërtimit, përdorimit të materialeve dhe shprehjes arkitektonike. Sa i përket aplikimit tradicional të drurit, Bouzek konstaton se mbetjet e ndërtimeve në Ballkan dhe në Evropën qendrore dëshmojnë se ky art i ndërtimit të shtëpive është aplikuar gjerësisht në Evropë.² Megjithatë Kosova i mirëmban tiparet e saj identifikuese si refleksion i kulturës shqiptare të jetesës në vend. Duke filluar nga mesi i shekullit XX, me zhvillimin e industrisë së ndërtimit dhe me praninë e tullës së argjilës dhe betonit si materiale moderne, përdorimi i drurit ka rënë dukshëm. Sot, si në zona urbane po ashtu edhe rurale, gjenden shumë pak objekte bashkëkohore me karakter publik, që kanë drurin si material kryesor ndërtimor. Janë disa objekte hapësinore të ndërtuara me teknologjinë e aplikimit të drurit të laminuar gjatë viteve '80 dhe një objekt i ndërtuar në vitin 2001. Prej atëherë, nuk vërehet ndonjë tendencë drejt përdorimit të drurit në teknologjinë e ndërtimit.

Në këtë kontekst, ky punim hulumton dhe ilustron disa tipologji të ndërtimit me dru në dy aspekte: sistemet e ndërtimit tradicional dhe strukturat bashkëkohore, duke i analizuar dhe klasifikuar elementet strukturore si dhe duke interpretuar vlerat arkitektonike.

Arkitektura tradicionale e drurit

Arkitektura tradicionale në Kosovë interpretohet si arkitekturë vernakulare, që ndër të tjera, nënkupton përdorimin e materialeve dhe përvojave lokale, siç e përkufizon Rudofsky: "arkitekturë pa arkitekt apo arkitekturë pa origjinë të njohur".⁴ Arkitektura vernakulare në Kosovë është zhvilluar nën ndikimin e faktorëve të ndryshëm natyror-gjeografik dhe socio-ekonomik nga shekulli XVIII, veçanërisht gjatë shekullit XIX.^{5 6} Në objektet tradicionale të Kosovës, druri zë pjesë të rëndësishme krahas aplikimit të gurit dhe tullave të dheut. Elementet ndërtimore nga druri janë përdorur si strukturë mbajtëse apo i kombinuar në muratori, si përforcues. Ata janë aplikuar kryesisht në ndërtimin e shtëpive urbane dhe rurale, një apo më shumëkatëshe, por gjenden edhe në objekte të karaktereve të tjera si, hane apo çarshia.

Që këtej, studimi fokusohet në objekte banuese si tipologji kryesore, duke i paraqitur elementet strukturore dhe jostrukturore nga druri si dhe pjesët ornamentale në brendi. Sistemet e tilla arkitektonike janë përdorur përgjatë gjithë vendit, duke ndarë karakterin e përbashkët të shfrytëzimit të hapësirës që pohon traditën e gjatë dhe të shkëlqyer të mjeshtrisë ndërtimore vendore.⁷ Megjithatë, është e ruajtur veçantia në kuptimin e vëllimit, shtrirjes hapësinore dhe trajtimit të fasadës. Janë dy tipologji kryesore të shtëpive tradicionale në Kosovë: shtëpitë tradicionale urbane dhe ato rurale. Dallimi kryesor mes objekteve brenda tipologjive qëndron në madhësinë e përgjithshme, teknikat e ndërtimit dhe dekorimet e brendshme,

⁴ Bernard Rudofsky, *Architecture Without Architects: A Short Story to Non-Pedigreed Architecture*, New Mexico: University of New Mexico Press, 1987 (1964), pp.7. University of New Mexico Press, 1987 (1964), pp.7.

⁵ Branislav Kojić, *Seoska arhitektura i rurizam*, Beograd: Gradevinska knjiga, 1973.

⁶ Fejaz Drançolli, *Kulla Shqiptare*. Kosovo: Rezniki, 2001

⁷ Flamur Doli, *Shkolla kosovare e mjeshtrit popullor shqiptar*, Kosovë: Zëri, 1993.

të pasuruara me ornamente estetike dhe të detajuara tradicionale të shprehura në dru.⁸

Shtëpitë tradicionale urbane

Arkitektura tradicionale urbane është zhvilluar kryesisht gjatë shekullit të XIX deri me paraqitjen e materialeve të reja moderne, si betoni i armuar dhe tulla e argjilës. Janë përdorur materiale me strukturë të përzier nga druri, guri dhe tulla duke përfutur veçori të caktuara arkitektonike, si: konstruktive, funksionale dhe estetiko-artistike.⁹ Shtëpitë janë kryesisht familjare, një deri dy kate, të shpërndara në shtrirjen urbane të qytetit. Nuk ekziston një klasifikim i shtëpive urbane sa i përket prezencës së elementeve strukturore nga druri, megjithatë vihen re dy tipe kryesore sipas elementeve strukturore të mureve.

Shtëpia me skelet druri - është sistem i ndërtimit, e cila përgjatë historisë ka qenë prezent në shumë vende botërore. Elementet nga druri në këtë tipologji krijojnë skeletin për mbushje nga tullat, gurët apo qerpiçi (fig. 1). Zakonisht muret e bodrumit janë të ndërtuara nga gurët dhe tullat me qerpiç, të përforcuara me trarë horizontale të drurit. Muret janë elemente mbajtëse, andaj shërbejnë si themele derisa kati i sipërm është i ndërtuar në sistem skeletor nga druri. Skeleti është i formësuar nga shtyllëzat, zakonisht 14x14cm të mbërthyer me diagonale dhe horizontale, duke ofruar mbështetje laterale për objektin. Diagonalet janë të vendosura në qoshe duke i mbështetur shtyllat e objektit. Elementet janë të montuara me lugëz të prerë me dorë dhe të forcuara me gozhda. Muret janë të mbyllura me plafonë të formuar me trarë dhe trarëza të vendosura në

⁸ Emin Riza, *Qyteti dhe banesa qytetare shqiptare shek. XV-XIX*, Shqipëri: Dita 2000, 2009.

⁹ Fejaz Drançolli, *Destruction of Albanian Kulla*, Kosovë: Reznici, 2004.

intervale 40-55cm. Struktura e kulmeve të pjerrëta është gjithashtu e ndërtuar përmes profileve drejtkëndëshe të drurit.



Figura 1. Shtëpi me skelet druri në Kosovë

Në përgjithësi, shtëpia me skelet druri përbëhet nga katër pjesë kryesore strukturore:

- përdhesa nga muratura apo themeli
- dyshemeja nga profile druri
- muret e katit nga profilet e drurit
- kulmi nga struktura e drurit

Shtëpia me strukturë të kombinuar - është tipologji e zhvilluar gjatë shekujve XVIII dhe XIX, duke inkorporuar traditën e pasur të kulturës dhe artit shqiptar brenda kompozicionit, prandaj ka vlerë të veçantë si pjesë e arkitekturës kombëtare. Këto lloj objektesh janë kryesisht shtëpi familjare me variacione për nga madhësia në relacion me gjendjen social-ekonomike të familjeve të caktuara. Në këto shtëpi një deri dy katëshe, banimi është i shtrirë në katin e sipërm, derisa përdhesa përfshihet nga hapësirat plotësuese për familjen (fig. 2).



Figura 2. Shtëpi me strukturë të kombinuar në Kosovë

Në këtë tipologji, materialet kryesore janë guri me llaç dhe brinjët horizontale nga druri, të ndërthurrura brenda mureve mbajtëse. Këto mure janë zakonisht 65-80cm të gjëra, derisa në katin e sipërm shtrirja funksionale është më fleksibile e kufizuar me mure më të holla, me profile druri dhe të suvatuara në të dy anët. Pjesët kryesore të shtëpisë të formësuara nga përdorimi i drurit janë dyshemetë, ballkoni i hapur ose i mbyllur, i cili është i mbështetur nga shtyllat e drurit, erkerët e drurit dhe kulmi me strukturë druri.

Sisteme të ngjashme ndërtimi gjenden edhe në çarshitë tradicionale të ndryshme urbane në vend (fig. 3), të zhvilluara në qendra të qyteteve. Ato ofronin funksione artizanale, tregtare dhe administrative të kohës.¹⁰ Njësitë përbëheshin nga një ose dy kate, me shprehje të theksuara arkitekturore përmes aplikimit të drurit, gurit dhe qerpiçit brenda strukturës kompozicionale.



Figura 3. Entitet urban – Çarshia e madhe, Gjakovë

Elementet kryesore strukturore nga druri janë: trarët primarë horizontale, që shërbejnë për mbështetjen e elementeve vertikale strukturore, dritaret e dala, apo erkerët, shtyllat, trarët, struktura e kulmit, struktura e dritareve dhe dyerve si dhe elementet përcjellëse funksionale, të gjitha të kompozuara me artin e pasur popullor.

¹⁰ Ministria e Rinisë dhe Sportit, 2015 [Online] Në dispozicion në: http://dtk.rks-gov.net/tkk_objekti_en.aspx?id=1259 [parë për herë të fundit më: 03/2015].

Elementet strukturore

Trarët janë të mbështetur përmes mureve mbajtëse nga ana e ngushtë e hapësirës si dhe nga trau përforcues i shtrirë në ortogonale. Ata kanë seksion kuadrati ose drejtkëndor rreth 25x25cm, të vendosur në intervale 50-70cm, që shfaqen qartë në përdhësë (fig. 4). Trarët dytësorë, me seksion 14x20cm shtrihen mbi trarët primarë dhe mbulohen me dërrasa. Në rastet kur kati i sipërm dallon nga ai i poshtëm, trarët primarë janë zgjatur duke krijuar strukturë të dalë konsolë, që mban ngarkesat nga kati i sipërm (fig. 5). Elementet janë të vendosura përmes montimit dru-dru dhe nganjëherë të përforcuara edhe me gozhda.



Figura 4. Trarët nga druri




Figura 5. Erkerët nga druri; vizatimet në të djathtë nga F. Kuleta and A. Gashi

Strukturë e veçantë e shtëpisë, e ndërtuar nga druri është edhe erkeri dhe dritaret e dala (fig. 6), kryesisht të orientuara nga kopshti. Aplikimet e tilla kanë mundur fleksibilitet më të madh në katin e sipërm si hapësirë e mbyllur apo kanë

mbështetur ballkonet e hapura ose të mbyllura të shtëpisë. Ekzekutimi i tyre është bërë përmes mbivendosjes së rendeve të caktuara të trarëve të drurit, duke formësuar strukturë impulsive me veçori origjinale.¹¹



Figura 6. Erkerët nga druri, vizatimet në të djathtë (Doli, 2001), fotot nga autorja

Çdo funksion i jetës së përditshme është projektuar me kujdes brenda kompozicionit të shtëpisë dhe është ndërtuar me saktësi dhe elegancë. Shembull i tillë është edhe struktura e dalë në fasadë, pjesë e kuzhinës, duke mundësuar largimin e ujit të përdorur, i cili ka përfunduar duke ujitur kopshtin e shtëpisë (fig. 7). Dyert dhe dritaret janë të kompozuar me elemente plotësuese të bukura nga druri.



Figura 7. Struktura të jashtme nga druri

Shtyllat kanë seksion kuadratik, rreth 20x20cm, të cilat mbështesin ballkonet si dhe strukturën e kulmit. Ballkonet e hapur/mbyllur apo zgjerimet e katit të sipërm mbështeten në trarë kryesorë periferikë, të cilët mbështeten në shtylla, elemente, të cilat janë të montuara përmes nyjeve me lugje - njëshe apo

¹¹ Flamur Doli, *Arkitektura tradicionale popullore e Kosovës*, Kosovë: Flamur Doli, 2001

dyshe. Shtyllat e drurit vendosen mbi thembratën e gurtë, drejtkëndëshe apo poligonale (fig. 8). Në katin e sipërm, në rastet e shtëpive më të mëdha me distanca më të mëdha mes mureve mbajtëse, janë një apo më shumë shtylla në qendër të hapësirës në mënyrë që të mbështesin horizontalisht muret më të holla ndarëse.



Figura 8. Shtyllat nga druri

Dekorimi i brendshëm

Siç është theksuar më herët, meqë familja ishte e organizuar në katin e sipërm, ai kat është më i detajuar në relacion me katin e poshtëm, ku kryheshin funksione plotësuese të familjes. Kati është veçanërisht i pasuruar me ballkonet e hapur ose gjysmëhapur, të cilat përdoren gjatë stinës së verës, duke e zgjeruar kështu hapësirën banuese. Është e rëndësishme të theksohet puna e artit popullor brenda shtëpisë. Numër i konsiderueshëm i pajisjeve dhe mobilimit të shtëpisë janë punuar nga druri me dorë, duke formësuar kompozicione të shkëlqyera të simboleve florale dhe gjeometrike, pra duke shënjuar vulën identifikuese të kohës dhe kulturës së artit kosovar.

Shembuj të punës artistike të formësuar në plafonë janë paraqitur në foton vijuese (fig.9). mobilie nga druri, si pjesë integrale e hapësirës së banimit, siç janë raftet, kamaret, dollapi i rrobave etj (fig. 10).



Figura 9. Dekor artizanal nga druri në plafon



Figura 10. Elemente artizanale nga druri në hapësirën banuese

Shtëpitë tradicionale rurale

Ndërtimi i vjetër rural në Kosovë është gjithashtu i njohur përmes ndërtesave banuese si rezultat i artit dhe mjeshhtërisë së trashëguar vendore. Ndërtesat rurale janë të kompozuar në dy kate, ku kati i sipërm shpërfaq dinamizmin e kompozicionit. Materialet e përdorura në banesat rurale ishin një bashkëdyzim i gurit si materiali kryesor ndërtimor, si dhe drurit e qerpiçit. Tipologjitë e ndërtesave rurale janë gjeneruar sipas teknikave, kompozicionit dhe estetikës së arritur nga mjeshtrit popullorë gjatë shekujve VIII dhe XIX.¹² Në këtë punim janë elaboruar tipologjitë me komponentë nga druri, respektivisht: shtëpia me ballkon, shtëpia me verandë dhe kulla (shtëpia e fortifikuar). Këto shtëpi inkorporojnë elemente strukturore nga druri, si dhe pajisje plotësuese në shkallë të vogël brenda kompleksit të shtëpisë, siç është hambari.

¹² Fejaz Drançolli, *Kulla shqiptare*, Kosovë: Rezniciq, 2001.

Shtëpia me ballkon është shtëpi drejtkëndëshe në planimetri, e zhvilluar në dy kate. Muret e jashtme nga guri janë të përforcuara horizontalisht përmes trarëve nga druri duke i mbërthyer muret mes tyre. Kati i sipërm është i mbështetur nga muret dhe nga dy ose më shumë shtylla druri. Shtylla formësohet nga themeli i gurtë, trupi dhe kapiteli i drurit. Trarët e mbështetur në kapitel mbajnë muret ndarëse të katit. Ballkoni është pjesa qendrore e fasadës kryesore, e ndërtuar tërësisht nga elementet e drurit (fig.11).




Figura 11. Shtëpia me ballkon nga druri (Drançolli, 2001)

Shtëpia me verandë karakterizohet nga veranda e hapur ose gjysmëhapur në katin e parë. Veranda është e ndërtuar nga elemente të drurit të montuara së bashku (fig. 12). Teknika e ndërtimit është e njëjtë si ajo e shtëpisë me ballkon, megjithatë dallimi qëndron në madhësinë dhe organizimin funksional të katit të parë. Nga jashtë, "dhoma e mysafirëve" – Oda, e cila shërbente për burra, qasej direkt përmes shkallëve të drunjtja, derisa pjesët e tjera të shtëpisë qaseshin përmes shkallëve të drunjtja sekondare, që ndodheshin brenda shtëpisë.



Figura 12. Shtëpia me verandë të drunjtë (Drançolli, 2001)

Kulla - është fortesë shqiptare, ku teknikat e fundit të ndërtimit dhe elementeve mbrojtëse janë sintetizuar me kulturën e jetesës, gjatë shekullit VIII dhe XIX, siç pohon Drançolli: "Kulla shqiptare aplikon elementet tradicionale shqiptare, të cilat mund të vërehen prej antikitetit deri tek dekada e parë e shekullit XIX".¹³



Figura 13. Elemente nga druri në Kulla dhe hambarët brenda kompleksit; vizatimi poshtë (Doli, 2001)

Kulla ka planimetri drejtkëndore e kompozuar nga dy deri katër kate. Përdhesa është përdorur si hangar për strehimin e kafshëve shtëpiake, kati i parë shërbente si depo dhe "shtëpi e zjarrit", në katin sipër ndodhej Oda, apo dhoma e mysafirëve. Në vendet në afërsi të pyjeve, druri zinte vend për elemente strukturore si edhe për dekorime brenda shtëpisë dhe hapësirat plotësuese jashtë. Dyshemetë ishin të ndërtuara nga elemente prej druri të mbështetura nga muret e jashtme dhe nga shtylla qendrore brenda ndërtesës, e cila mbështeste muret ndarëse gjithashtu. Siç është e paraqitur në fig. 13, elemente të ndryshme nga druri janë

¹³ Fejz Drançolli, *Destruction of Albanian Kulla*, Kosovë: Rezniqui, 2004

të integruara në kompozimin e shtëpisë Kullë-dysheme nga druri, shkallët e mbuluara të jashtme, dera kryesore, dysheku i drurit, hambarët etj.

Arkitektura bashkëkohore nga druri

Gjatë zhvillimit të arkitekturës bashkëkohore në Kosovë, tendencë e veçantë e aplikimit të drurit në arkitekturë vërehet gjatë viteve '80. Është periudha gjatë së cilës ekonomia dhe urbanizimi marrin hov në Kosovë, pak kohë para fillimit të rrënimit të Federatës Jugosllave. Dominuese ishin projektet e karakterit publik që në kontekstin e teknologjisë së aplikuar dhe shprehjes arkitektonike ishin në linjë me zhvillimet në rajon. Vetëm katër objekte me bazë druri janë vrojtuar, me strukturë nga druri i laminuar, tri nga të cilat janë ndërtuar gjatë viteve '80 dhe shembulli i katërt në vitin 2001. Të dhënat e përgjithshme janë marrë gojarisht meqë, në arkivat e qyteteve dokumentacioni ka munguar.

Objekt hapësinor në Pejë (fig.14) ka qenë pjesë e kompleksit të fabrikave për inxhinieri automobilistike. Objekti ishte restaurant me të gjitha hapësirat përcjellëse për punëtorët e ndërmarrjes. Është hapësirë 30x30m me lartësi 7m (siç është përlloritur) dhe e mbuluar me strukturë të parafabrikuar të laminuar. Është i dizajnuar dhe prodhuar nga ndërmarrje nga Bosnja dhe e montuar nga një ndërmarrje Sllovene në vitin 1984. Salla mbulohet nga tetë mbajtës kryesorë, katër nga të cilët në qoshe janë të përforcuar me katër mbajtës më të vegjël. Mbajtësit kryesorë janë të lidhur në qendër përmes çernierës rrethore metalike, derisa ata përforcues lidhen përmes pllakave metalike dhe bulonave në mbajtësit kryesorë. Mbajtësit janë të vendosur në intervale 5m dhe të mbështetur në thembrat nga betoni i armuar.



Figura 14. Strukturë hapësinore nga druri i laminuar, Pejë

Hallë sportive në Vushtrri (fig. 15) është ndërtuar në vitin 1984 nën rrethana të ngjashme dhe nga ndërmarrjet e njëjta si objekti i lartpërmendur. Halla përbëhet nga dy hapësira, të dyja të mbuluara me strukturë nga druri i laminuar. Hapësira e parë është hyrja, e mbuluar nga katër trarë linearë të mbështetur në shtylla nga betoni i armuar, ndërsa halla kryesore është 50x50m, me lartësi 9m. Dhjetë palë mbajtës linearë e mbulojnë hallën, në intervale të rregullta nga 5m. Mbajtësit janë të lidhur mes tyre përmes çernierave metalike. E tërë struktura është e mbështetur nga themelet e veçuara nga betoni i armuar. Kulmi mbështetet në trarët sekondarë të mbivendosur në mbajtësit kryesorë dhe të lidhur përmes varësve metalikë.



Figura 15. Strukturë hapësinore nga druri i laminuar, Vushtrri

Shkollë fillore në Qabër (fig. 16). Në vitin 2001, iniciuar nga një organizatë ndërkombëtare është ndërtuar një shkollë e re në fshatin Qabër, tërësisht e shkatërruar gjatë luftës së fundit. Shkolla është projektuar, parafabrikuar dhe montuar nga kompani ndërkombëtare (sipas të dhënave gojore, nga Bosnja). Struktura është dyhapësinore nga mbajtësit e laminuar të

mbështetur në shtylla druri, të cilat në periferi janë të përforcuara nga trarë horizontale me prerje katrore dhe përmes litarëve metalikë në formë X dhe V. Muret e jashtëm janë të përforcuar nga shtylla dhe trarë me seksion 14x14cm dhe me litarë në formë X. E gjithë struktura është e dukshme dhe pjesë e ambientit të shkollës.




Figura 16. Strukturë hapësinore nga druri i laminuar, Qabër

Diskutim dhe përmyllje

Objektivi kryesor i këtij studimi është të ofrohet një pasqyrë e përgjithshme, bazuar në arkitekturën e shqyrtuar me bazë nga druri në Kosovë, si dhe literaturën e lidhur me veçoritë arkitektonike dhe strukturore dhe si rrjedhojë të theksohet roli i drurit si material natyror dhe i ripërtërirë në identitetin arkitektonik të Kosovës.

Në arkitekturën vernakulare me bazë druri në Kosovë, mbizotëron gjurma e mjeshtrit popullor, ku perfeksionimi i teknikës dhe ndjesia e artit vendor është zhvilluar dhe konservuar përgjatë shekujve. Vetë prania e një numri të konsiderueshëm të shtëpive me bazë druri vërteton stabilitetin, pra vërteton qëndrueshmërinë e ndërtimit me dru kur aplikohet në mënyrën e duhur.

Arkitektura bashkëkohore nga druri është e përkufizuar përmes karakterit publik. Studimi në terren i ndërtesave me strukturë nga druri i laminuar dëshmon qëndrueshmërinë dhe në të njëjtën

kohë veçantinë strukturore si pjesë e shprehjes në arkitekturën e brendshme. Nevoja për objekte publike hapësinore, teknologjia e avancuar e ndërtimit dhe shtytja e autoritetit ndërkombëtar, janë disa nga faktorët të cilët e përcaktojnë karakterin e ndërtesave bashkëkohore me dru.

Disa përfundime të pohuara:

- Është i dukshëm boshllëku kohor në mes fundit të ndërtimit tradicional me dru dhe aplikimit bashkëkohor me dru

- Derisa arkitektura tradicionale identifikohet përmes tipologjisë banuese, arkitektura e re njihet për nga karakteri publik

- Vërehet mungesë e prirjes drejt aplikimit të drurit në sektorin banues dhe publik, prandaj edhe mungesa e besimit të drurit në arkitekturë është e evidente

- Ekspertiza e mjeshhtërisë vendore në përdorimin e drurit është dukshëm drejt shuarjes

Arkitektura vernakulare nga druri ka nevojë për më shumë vëmendje profesionale dhe studime të mëtejshme mbi veçoritë teknike dhe artistike të aplikuara, prandaj njohuria duhet të bartet tek gjeneratat e reja që t'u ofrohen njohuritë e nevojshme dhe të kërkueshme për të ofruar mirëmbajtje të duhur të tipologjive të mbetura. Arkitektura vendore nga druri duhet të eksplorohej tutje dhe të dokumentohet për të mundësuar krijimin e teknikave të reja aplikuese, të bazuara dhe inspiruara nga mjeshhtëria tradicionale dhe mbështetja profesionale akademike. Në fund, përmes përdorimit të burimeve vendore, industria lokale duhet të mbështetet dhe inkurajohet për të ofruar mundësi të reja të zhvillimit ekonomik të vendit.

Bibliografia

Bouzek, Jan. "Wooden Architecture: Combining different techniques". Vol.19, No.19. Kroaci: Histria Antiqua, 2010. pp.83-87.

Doli, Flamur. *Shkolla kosovare e mjeshtrit popullor shqiptar*. Kosovë: Zëri, 1993.

Doli, Flamur. *Arkitektura tradicionale popullore e Kosovës*. Kosovë: Flamur Doli, 2001.

Drançolli, Fejaz. *Kulla Shqiptare*. Kosovë: Rezniqui, 2001.

Drançolli, Fejaz. *Destruction of Albanian Kulla*. Kosovë: Rezniqui, 2004.

Instituti për Planifikim Hapësinor. *Spatial Plan of Kosova 2010 – 2020+*. Prishtinë: Ministria e Ambienti dhe Planifikimit Hapësinor, 2010.

Kojić, Branislav. *Seoska arhitektura i rurizam*. Beograd: Gradevinska knjiga, 1973.

Riza, Emin. *Qyteti dhe banesa qytetare shqiptare shek. XV-XIX*. Shqipëri: Dita, 2009.

Rudofsky, Bernard. *Architecture Without Architects: A Short Story to Non-Pedigreed Architecture*. New Mexico: University of New Mexico Press, 1987.

Burime nga interneti:

1.Ministria e Rinisë dhe Sportit, 2015. http://dtk.rks-gov.net/tkk_objekti_en.aspx?id=1259 [parë për herë të fundit më: 03/2015].

Vërejtje:

*Të gjitha fotografitë janë nga autori, përveç nëse citohet ndryshe